

# Biografi

Pranvera Hoxha - Pianiste. Mësimet e para në piano i nisi nëmoshën 10 vjeçare me pedagogen Hadije Gjinali. Shkollën e mesme e përfundoi në Prishtinë nëklasën e prof. Agron Shujaku. Ndërkaq studimet e larta i vazhdoi në Akademinë e Arteve të Bukura – Tiranë nëklasën e Prof. Anita Tartari.

Nga viti 2006-2009 ka ndjekur studimet në Fakultetin Ekonomik – Banka, Financa dhe Kontabilitet pran Universitetit Iliria –Prishtinë.

Në shkurt 2010 ka regjistruar studimet e magjistraturës në fakultetin e Muzikës –Shkup dhe mbaroi në Tetor – 2011 te prof. T.Svetiev me notën maksimale.

Gjate këtyre viteve ka marr pjesë në shumë Festivale si: Java e Bahut (2000), Festivali i Muzikës Kamertale (2000) Festivali i Shopenit –Tirane, Prishtine ( 2002, 2013), Festivali Dam(2007), ReMusica (2008/09) dhe Tingujt e Flautit (2011/12).

Krahas këtyre koncerteve ka realizuar dhe koncerte solo (1998, 2000, 2001, 2006, 2012)

Ka pasur bashkëpunim me Korin-Opera e Kosovës si dhe me Filarmoninë e Kosovës në cilësinë e Korreperitores. Gjithashtu me Fakultetin e Muzikës – Prishtinë ka bashkëpunuar si korrepetitore dhe më 2011 angazhohet në Universitetin Shtetërorë të Tetovës si korreperitore e kantos dhe flautit.

Është anëtare e Orkestrës Kamertale "Rexho Mulliqi" me të cilin realizoi disa koncerte në Kosovë, Festivali " Tingujt e Flautit" (2011) dhe në Teatrin "Le Palas" në Paris.

Aktualisht punon si Korrepetitore ne klasen e Flautit prane Universitetit te Prishtines - Fakulteti i Muzikes dhe pedagoge e pianos në SH.M.M. "Prenk Jakova" në Prishtinë